

VENDIM
Nr.280, datë 21.4.2005

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË AKSIONARËVE TË BANKËS ITALO-SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të ligjit nr.9313, datë 11.11.2004 “Për privatizimin e aksioneve, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës Italo-Shqiptare”, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së aksionarëve të Bankës Italo-Shqiptare, për transferimin e së drejtës së pronësisë së aksioneve të kësaj Banke, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano